

**GJYKATA E APELIT
PRISHTINË**

NË EMËR TË POPULLIT

Numri i lëndës: PAKR 229/15
Më: 30 nëntor 2015

Gjykata Themelore: Në Mitrovicë, P 33/12

Originali: anglisht

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it pranë Gjykatës së Apelit Hajnalka Veronika Karpati, si kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese dhe nga gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit Abdullah Ahmeti dhe gjyqtari i EULEX-it pranë Gjykatës së Apelit Radostin Petrov, si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Alan Vasak, zyrtar ligjor i EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtësit,

Në lëndën lidhur me të pandehurin:

(SP)

[REDACTED]

në paraburgim që nga data 20 tetor 2011

I akuzuar në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës PP 158/2011, të ngritur më 17 prill 2011 dhe të ndryshuar më 28 shkurt 2014, për veprat:

Vrasje e rëndë në tentativë, në kundërshtim me nenin 147, par. 7 të Kodit të Krimit Penal të Kosovës (KPPK), lidhur me nenin 23 të KPK-së; dhe
Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve të zjarri në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së;



I gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me aktgjykimin P 33/13, të datës 8 dhjetor 2014, me të cilin

I pandehuri ^(SP) [redacted] është shpallur fajtor për veprën grabitje e rëndë në tentativë, në kundërshtim me nenin 329, par. 5 të KPK-së, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së ndërsa është shfajësuar për veprën vrasje e rëndë në tentativë; i pandehuri ^(SP) [redacted] po ashtu është shpallur fajtor për mbajtje në pronësi, në kontroll apo në posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, par. 1 të KPRK-së; i pandehuri

^(SP) [redacted] është dënuar me dënimin unik prej 10 (dhjetë) vjetësh burgim;

Duke e shqyrtuar ankesën e parashtruar nga mbrojtësi ^(NY) [redacted] më 24 mars 2015;

Pas shqyrtimit të përgjigjes së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, të parashtruar më 2 prill 2015;

Duke e marrë parasysh propozimin e prokurorit të apelit të shtetit, të parashtruar më 8 korrik 2015,

Pas mbajtjes së seancës publike të Gjykatës së Apelit më 26 nëntor 2015;

Pas këshillimit dhe votimit më 30 nëntor 2015;


Në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale (KPP);

E sjell këtë:

AKTGJYKIM

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit ^(NY) [redacted] për të pandehurin ^(SP) [redacted] kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore të Mitrovicës P 33/13, të datës 8 dhjetor 2014.

II. Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P 33/13, të datës 8 dhjetor 2014.



ARSYETIM

I. HISTORIKU I PROCEDURËS

I pandehuri ^(SP) është në paraburgim nga data 20 tetor 2011.

Më 17 prill 2012, Prokuroria Themelore e Mitrovicës e ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurit, ndërsa më 13 qershor 2012 aktakuza në fjalë është konfirmuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.

Më 27 nëntor 2013, lënda është marrë përsipër nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it.

Më 28 shkurt 2014, është mbajtur seanca fillestare dëgjimore.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur më 21, 22 dhe më 23 tetor 2014 si dhe më 3, 4 dhe më 5 dhjetor 2014, ndërsa aktgjykimi është shpallur më 8 dhjetor 2014.

Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar të pandehurit më 11 mars 2015. I pandehuri, përmes avokatit mbrojtës, e ka apeluar aktgjykimin më datën 24 mars 2015.

Më 2 prill 2015, Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka parashtruar përgjigje në ankesën në fjalë.

Lënda i është kaluar Gjykatës së Apelit për vendosje të ankesës më datën 8 maj 2015.

Më 8 korrik 2015, prokurori i apelit i shtetit e ka parashtruar përgjigjen.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit është mbajtur më 26 nëntor 2015 në praninë e të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të apelit të shtetit të EULEX-it Claudio Pala.

Kolegji ka mbajtur këshillimin dhe votimin më datën 30 nëntor 2015.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e mbrojtjes

Mbrojtësi ^(NV) ka paraqitur ankesë brenda afatit të përcaktuar më 24 mars 2015.
pretenduar:



- shkeljen e ligjit penal
- vërtetimin e gabueshëm të gjendjes faktike dhe
- vërtetimin e dënimit

Të gjitha këto lidhur me pikën e grabitjes së rëndë në tentativë.

Ai pretendon se gjykata në mënyrë të pasaktë e ka cilësuar veprën penale në fjalë si grabitje e rëndë në tentativë sipas nenit 329, par. 5 të KPK-së, pasi që nuk ka ardhur gjër te vdekja si pasojë e nevojshme për cilësimin në fjalë. Cilësimi i drejtë do të ishte në bazë të nenit 329, par. 4, kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, i cili bart në vete dënim më të butë. Ai pretendon se provat e prezantuara tregojnë se i akuzuari nuk kishte fare si qëllim privimin nga jeta të shoferit të taksisë. Po ta kishte pasur ai këtë qëllim prej fillimit atëherë pse do të ishte brengosur mos do të ishte njohur më vonë dhe pse do të kërkonte nga një person tjetër ta merrte taksinë.

Mbrojtësi pohon se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabueshme nga ana e trupit gjykues për arsye se – duke u bazuar në faktet të cilat janë provuar gjatë procedurës – gjykata ka ardhur deri tek konkluzioni i gabuar kur ka deklaruar se i akuzuari ka vepruar në mënyrë të qëllimshme duke pasur si synim marrjen e veturës si dhe privimin nga jeta të ngasësit të saj.

Mbrojtësi pretendon se rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese janë përcaktuar gabimisht nga ana e trupit gjykues. Kolegji ka gjetur vetëm një rrethanë lehtësuese, mungesën e dënimit të mëparshëm, por edhe kësaj rrethane gjykata nuk i ka kushtuar rëndësi të plotë. Gjykata po ashtu e ka injoruar në tërësi pranimin e plotë të veprës penale edhe pse shumë prej fakteve të vërtetuara nga gjykata kanë mundur të vërtetohen vetëm me pranimin e tyre nga i akuzuari. Gjykata gjithashtu nuk e ka pasur parasysh faktin se për fat të mirë nuk ka pasur pasoja të rënda dhe pas trajtimit pala e dëmtuar është shëruar plotësisht. Po ashtu edhe keqardhja e sinqertë dhe e njëmendët e të akuzuarit është dashur të llogaritet si një rrethanë lehtësuese, ashtu sikurse edhe rrethanat e tija personale, fakti që ai është i papunë, që ai dhe familja jetojnë në varfëri, që ai është i martuar dhe e ka një vajzë tetë vjeçare dhe se prindërit i ka të moshuar dhe të sëmurë rëndë për shkak se nuk kanë mundësi ta paguajnë trajtimin e domosdoshëm mjekësor. Për më tepër, pala e dëmtuar nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim. Lëndimet e tija, pavarësisht sa të rrezikshme kanë qenë në teori, në realitet nuk kanë qenë aq serioze apo të rrezikshme për jetën, gjë e cila është dashur të merret në favor të një dënimi më të butë pasi që vetë pala e dëmtuar nuk ka qenë i interesuar në ndjekjen e tij penale.

Sa iu përket rrethanave rënduese, një faktor të cilin kolegji e ka marrë parasysh e shpreh rregullisht e vlerësimit të dyfishtë. Zaten “mosrespektimi i jetës së njeriut” apo “privimi i jetës së dikujt” janë elemente cilësuese të veprës penale të përcaktuar me nenin 329, par. 5. Për këtë arsye gjë nuk mund të shqyrtohet për të dytën herë dhe t’i shqiptohet të pandehurit një dënim më i ashpër.



Mbrojtësi pohon se gjykata në mënyrë të gabueshme e ka konsideruar keqardhjen e të pandehurit të shprehur para trupit gjykues si keqardhje jo të vërtetë dhe për këtë arsye ajo e ka konsideruar gabimisht këtë si një rrethanë rënduese. I pandehuri e ka shprehur keqardhjen e tij në rastin e parë kur i është dhënë mundësia për të dhe madje edhe e kishte shprehur këtë gjatë gjykimit derisa e kishte pritur ardhjen e palës së dëmtuar pasi që kishte dëshirë t'i kërkonte falje dhe t'i tregonte se sa thellë ishte penduar për atë çfarë kishte ndodhur.

Ai më tej pohon se edhe sikur ta kishte konstatuar Gjykata e Apelit se cilësimi fillestar qëndron, prapë se prapë dënimi do të ishte shumë i ashpër. Ai pretendon se në praktikën gjyqësore të Kosovës askush që është shpallur fajtor për veprën penale të grabitjes në tentativë në bazë të nenit 329 të KPK-së, pavarësisht sipas të cilit paragraf është cilësuar vepra në fjalë, nuk është dënuar kaq ashpër.


Mbrojtësi i propozon Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke e shpallur të akuzuarin [redacted] fajtor për kryerjen e veprës penale të grabitjes sipas nenit 329, par. 4 të KPK-së duke i shqiptuar një dënim të ulët ose në rast se ajo e konfirmon cilësimin juridik të gjykatë së shkallës së parë, duke i shqiptuar një dënim më të butë sesa ky.

B. Përgjigjia e PSRK-së

Prokurori Tomas Skala më datën 2 prill 2015, e ka parashtruar përgjigjen e tij në ankesën e mbrojtësit [redacted]. Lidhur me pretendimin e bërë në ankesë se mungon elementi subjektiv për shkak të mungesës së dashjes së të pandehurit për t'i shkaktuar vdekjen, prokurori deklaron se një pretendim i tillë duhet të hedhet poshtë si i pabazë. Ai pohon se edhe një njeri i thjeshtë duhet ta dijë se duke e qëlluar me armë zjarri dikë në qafë nga mbrapa është jashtëzakonisht e mundshme të vritet ai person. Pasoja fatale nuk ka ndodhur pavarësisht çfarë ka qenë dashja e të pandehurit. E njëjta gjë vlen edhe për pretendimin se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht; tashmë është provuar qëllimi vrastar i të pandehurit, i pandehuri ka vepruar së paku me dashje eventuale.

Lidhur me pretendimin e tretë të bërë në ankesë, prokurori pretendon se gjykata i ka vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Keqardhja e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte dukur sikur e shtirë. Është krejt e parëndësishme në këtë aspekt nëse pala e dëmtuar i është bashkëngjitur ndjekjes penale apo ka bërë kërkesë për kompensim. Gjithashtu është e kontestueshme nëse sjellja kriminale e të pandehurit mund të justifikohet me varfërinë e tij të pohuar. Po ashtu, mungesa e pasojës fatale nuk mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese ngase kjo ka ndodhur pavarësisht dashjes dhe besimit të të pandehurit.

Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën dhe ta vërtetojë aktgjykimin.



C. Propozimi i prokurorisë së apelit

Prokurorja e apelit Judit Eva Tatrai, në propozimin e saj të datës 8 korrik 2015 pajtohet me përgjigjen e prokurorit se dashja e të pandehurit [REDAKTUAR] ka përmbajtur në vete edhe vrasjen e palës së dëmtuar. Nga faktorët objektivë të lëndës në fjalë nuk mund të vijmë në një konkluzion tjetër përveç këtij. Megjithatë, prokurorja e apelit është e mendimit se gjykata e ka shkelur ligjin penal kur e ka cilësuar veprimin e të pandehurit si grabitje e rëndë në tentativë në vend se ta cilësonte si vrasje e rëndë në tentativë e kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore. Faktet e vërtetuara tregojnë se i pandehuri nuk ka shtënë mbi palën e dëmtuar gjatë ose pas kryerjes së grabitjes ose me qëllim të thyerjes së rezistencës së viktimës. Ashtu siç është vërtetuar edhe në aktgjykim, i pandehuri [REDAKTUAR] ka shtënë me armë zjarri mbi palën e dëmtuar duke e qëlluar nga mbrapa në qafë, nga më pak se një metër distancë pa i dhënë mundësi për të rezistuar apo për ta parandaluar të pandehurin [REDAKTUAR] nga marrja e veturës. Ai së pari u mundua ta vriste me armë zjarri duke e gjuajtur viktimën në një hendek dhe vetëm pas kësaj ia kishte marrë veturën. Edhe pse prokurori themelor [REDAKTUAR] ka ushtruar ankesë, në bazë të nenit 394, par. 1, nënpar. 1.4 i KPP-së, Gjykata e Apelit duhet sipas detyrës zyrtare ta vërtetojë nëse ligji penal është shkelur në dëm të të akuzuarit. Ajo ia lë Gjykatës së Apelit ta vërtetojë nëse kjo shkelje ishte apo jo në dëm të të akuzuarit.


Sa i përket matjes së dënimit, prokurorja e apelit është e mendimit se gjykata themelore i ka vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe e ka shpjeguar qartë arsyen pse nuk e ka vlerësuar si të vërtetë keqardhjen e të pandehurit. Ajo i mbështet argumentet e prokurorit themelor, të dhëna në përgjigjen e tij dhe deklaron se edhe nëse merren parasysh gjendja familjare dhe varfëria e të akuzuarit, prapë dënimet individuale të shqiptuara si dhe dënim i unik është në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe se një dënim më i butë sesa ky nuk do të mund të justifikohet.

Prokurorja e apelit kërkon nga Gjykata e Apelit që ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetojë *ex officio* nëse ka pasur apo jo shkelje të ligjit penal dhe nëse kjo është bërë në dëm të të akuzuarit. Në përputhje me këtë, ajo duhet të vendosë lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nën pikën 1 të aktakuzës.

III. ÇËSHTJE PRELIMINARE

D. Kompetenca

Kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e vet në përputhje me nenin 472, paragrafi 1 të KPP-së dhe meqë nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga palët, kolegjit i mjafton me sa vijon: në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe aktgjykimet e lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX në Kosovë - Ligji nr. 03/L-069/2009, ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe i sqaruar përmes Marrëveshjes së arritur në mes të Shërbimit të EULEX-it



në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji nxjerr konkluzionin se EULEX-i ka kompetencë mbi lëndën dhe se është kompetent për të vendosur përkitazi me lëndën aktuale dhe do të ketë në përbërje një gjyqtar të Kosovës dhe dy gjyqtarë të EULEX-it.

E. Pranueshmëria e ankesës

Aktgjykimi i arsyetuar i është dorëzuar të pandehurit më datë 11 mars 2015. Ankesa në emër të të pandehurit është parashtruar brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë në përputhje me nenin 380, paragrafi 1 të KPP-së. Përveç kësaj, ankesa ishte parashtruar nga personi i autorizuar dhe përmban të gjitha informacionet e tjera sipas nenit 376 *et seq* të KPP-së. Pra ankesa është e pranueshme.

F. Ligji i Procedurës i zbatueshëm në këtë lëndë

Ligji i ri i Procedurës Penale ka hyrë në fuqi në Kosovë më 1 janar 2013 – pra Kodi i Procedurës Penale, ligji nr. 04/L-123. Ky kod e ka shfuqizuar Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale të Kosovës, i cili kishte hyr në fuqi më 6 prill 2004. Neni 545 i Kodit të tanishëm të Procedurës Penale parashih se përcaktimi nëse duhet apo jo të përdoret Kodi i tanishëm i Procedurës Penale, duhet të bazohet në datën e ngritjes së aktakuzës. Veprimet të cilat kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kodit të tanishëm duhet të jenë subjekt i Kodit aktual nëse procedura penale me të cilën hetohet dhe ndiqet penalisht ai veprim është iniciuar pas hyrjes në fuqi të këtij kodi.

Aktakuza në këtë lëndë është ngritur në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës më 17 prill 2012 para hyrjes në fuqi të Kodit të tanishëm të Procedurës Penale. Megjithatë shqyrtimi gjyqësor është iniciuar pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri përkatësisht më 28 shkurt 2014. Sipas nenit 545 të Kodit të tanishëm të Procedurës Penale, ligji i aplikueshëm procedural pra do të jetë Kodi i tanishëm i Procedurës Penale. Prandaj në përputhje me rrethanat, Gjykata e Apelit ka zhvilluar procedurën sipas Kodit të tanishëm të Procedurës Penale.

G. Kodi Penal i zbatueshëm në lëndë

Sikurse në mënyrë të drejtë është vërtetuar nga Gjykata Themelore, zbatimi i Kodit të tanishëm Penal, Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili ka hyr në fuqi më 1 janar 2013 është më i favorshëm për të pandehurin krahasuar me zbatimin e Kodit të vjetër Penal, Kodin Penal të Kosovës. Prandaj sipas nenit 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në këtë lëndë do të zbatohet Kodi aktual Penal.



IV. GJETJET E KOLEGJIT

A. Vërtetimi i gjendjes faktike dhe cilësimit juridik


a. *Të shtënat*

Edhe pse i pandehuri është akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, Gjykata Themelore – në përputhje me nenin 360, paragrafin 2 të KPP-së – e ka ri-cilësuar veprën penale si Grabitje e rëndë në tentativë. Gjykata Themelore pohon se nuk kanë mundur të vërtetohen elementet e vrasjes së rëndë në tentativë. Kolegji i apelit megjithatë nuk e ka të njëjtin konkluzion me Gjykatën Themelore. I pandehuri ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për faktin se ishte duke shkrepur armën nga afërsia dhe të drejtuar në pjesën e pasme të kokës së palës së dëmtuar. Prandaj i pandehuri me – më së paku dashje eventuale – ka shtë në palën e dëmtuar. Duke parë se si i pandehuri ka shkrepur armën nga afërsia e të drejtuar në pjesën e pasme të kokës së palës së dëmtuar, privimi nga jeta i palës së dëmtuar ishte jashtëzakonisht i pashmangshëm. Fakti që pala e dëmtuar ka mbijetuar është thjesht çështje fati, pasi që dihet mirë se plaga e shkaktuar në kokë nga arma e zjarrit, e në veçanti e shkaktuar nga afërsia, në të shumtën e rasteve do të ishte vdekjeprurëse. I pandehuri medoemos dhe duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për këtë fakt. Për këtë arsye i pandehuri kishte – më së paku dashje eventuale – për ta privuar nga jeta palën e dëmtuar. Vetëm pasi ka shtë në palën e dëmtuar dhe vetëm pasi e ka lënë për të vdekur, i pandehuri në mënyrë të paligjshme e ka përvetësuar automjetin të cilin ishte duke e ngarë pala e dëmtuar, pra ka siguruar dobi pasurore. Sipas këndvështrimit të kolegjit, veprimet e përshkuara më sipër dhe dashja (më së paku eventuale) plotësojnë të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë dhe për këtë arsye vepra penale është dashur të cilësohet si vrasje e rëndë në tentativë.

Megjithatë për shkak se Gjykata Themelore e ka ri-cilësuar veprën penale të provuar si grabitje e rëndë në tentativë dhe prokurori nuk e ka apeluar vendimin e Gjykatës Themelore, kolegji i Gjykatës së Apelit nuk mundet dhe nuk do ta ri-cilësojë veprën penale në dëm të të pandehurit, siç parashihet me nenin 395 të KPP-së.

Pra kolegji më poshtë në këtë tekst, do ta vlerësojë nëse është apo jo i drejtë cilësimi i veprës penale të grabitjes së rëndë në tentativë, në përputhje me nenin 329, paragrafi 5 të KPRK-së. Mbrojtja pohon se i pandehuri nuk e ka shkrepur armën me qëllim që ta privojë nga jeta palën e dëmtuar. Qëllimi ishte të shkrepë një të shtë për ta frikësuar palën e dëmtuar. E gërshetuar me faktin se pala e dëmtuar nuk ka vdekur, mbrojtësi prandaj paraqet se veprimi duhet të cilësohet sipas nenit 329, paragrafi 4 (grabitje e rëndë që rezulton në lëndim të rëndë trupor) dhe jo sipas nenit 329, paragrafi 5 (grabitje e rëndë që rezulton me vdekje) të KPRK-së.

Së pari, kolegji vë në pah se i pandehuri nuk është shpallur fajtor për veprën penale të grabitjes së rëndë (që rezulton me vdekje) por ai është shpallur fajtor për grabitje të rëndë në




tentativë (që rezulton me vdekje). Mbrojtja megjithatë paraqet se për shkak se pala e dëmtuar nuk ka vdekur, nuk mund të aplikohet paragrafi 5 i nenit 329 të KPRK-së. Kolegji nuk pajtohet me këtë pikëpamje dhe thekson sërish dhe vërteton analizën e bërë nga Gjykata Themelore respektivisht doktrinën e vërtetuar që nëse gjatë kryerjes së grabitjes pala e dëmtuar ka marrë vetëm plagë të lehtë ose të rënda trupore, por kryerësi megjithatë ka ndërmarrë veprime për ta privuar nga jeta palën e dëmtuar, vepra penale cilësohet si grabitje e rëndë në tentativë.¹ Sikurse është vërtetuar më sipër, i pandehuri kishte – më së paku dashje eventuale – për ta privuar nga jeta palën e dëmtuar. Për më tepër ai bile në mënyrë të paligjshme e ka përvetësuar veturën e palës së dëmtuar të cilën ishte duke e ngarë pala e dëmtuar. Për këtë arsye kolegji e vërteton cilësimin e veprës penale sipas nenit 329, paragrafi 5 të KPRK-së dhe pajtohet me arsyetimin e Gjykatës Themelore nga paragrafi 82 deri në paragrafin 97 të aktgjykimit të kundërshtuar me përjashtimin se të njëjtat fakte është dashur të cilësohen si vrasje e rëndë në tentativë sepse sulmi ndaj jetës nuk ishte për ta mbajtur sendin e vjedhur apo për ta thyer rezistencën por për të përfituar dobi pasurore.

b. Arma

Edhe pse nuk është ngritur nga asnjëra palë, kolegji konsideron se Gjykata Themelore në mënyrë të gabueshme e ka cilësuar akuzën për armë si mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 374, paragrafi 1 të KPRK-së. Kodi i tanishëm Penal bën dallimin në mes të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga njëra anë, dhe përdorimit të armës, nga ana tjetër. Vepra penale e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve parashihet me nenin 374 të KPRK-së kurse vepra penale e përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm parashihet me nenin 375 të KPRK-së. Është e qartë se i pandehuri e ka përdorur armën për të shtënë në palën e dëmtuar. Prandaj cilësimi i drejtë juridik i veprës penale është dashur të ketë qenë përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm sipas nenit 375 të KPRK-së, në vend të veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 374 të KPRK-së. Megjithatë kolegji nuk do ta ri-cilësojë veprimin si vepër penale të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm, pasi që kjo shkon në dëm të të pandehurit kurse prokuroria nuk ka parashtruar ankesë.

Për këtë arsye mbetet akoma i qëndrueshëm dënimi i tanishëm i paraparë me nenin 374, paragrafi 1 të KPRK-së edhe përkundër korigjimit se përshkrimi i veprës penale është të lexohet si "mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të armëve", pa fjalët "apo përdorimi i armëve".



¹ Srzentic Nikola – Ljubisa Lazarevic, Komentimi i Kodit Penal të Serbisë, 1995, Botimi i 5, "Savremena Administracija" Beograd, neni 169.

B. Vendimi mbi sanksionin penal

Mbrojtja e kundërshton përcaktimin e dënimit nga Gjykata Themelore duke e konsideruar atë jo të plotë dhe shumë të rëndë.

Kolegji me kujdes i ka shqyrtuar rrethanat rënduese të vërtetuara nga Gjykata Themelore dhe kundërshtimet e ngritura nga mbrojtja në këtë drejtim. Kolegji konsideron se, në kundërshtim me parashtrësën e mbrojtjes, Gjykata Themelore nuk i ka shqyrtuar edhe elementet e njëjta të veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor për përcaktimin e dënimit në fazën e caktimit të dënimit. Edhe pse neni 329, paragrafi 5 i KPRK-së përfshin elementin e vdekjes, nuk ka elemente të tjera të cilat kanë të bëjnë me shkakun dhe mënyrën e vdekjes. Prandaj Gjykata Themelore ka qenë brenda kufijve të saj për të përcaktuar se shpërfillja e plotë për vlerën e jetës së njeriut përbën rrethanë rënduese pasi kjo rrethanë nuk përbën element të nenit 329, paragrafi 5 të KPRK-së. Lidhur me shqyrtimin e Gjykatës Themelore që ka të bëjë me sakrifikimin e një vlere të lartë me qëllim jo madhor të marrjes së një përfitimi, kolegji vë në pah se Gjykata Themelore thjesht e ka përmendur këtë duke pasur parasysh gjakftohtësinë me të cilën i pandehuri ka vepruar. Lidhur me shqyrtimin e Gjykatës Themelore i cili ka të bëjë me privimin e një personi nga jeta, kolegji vë në pah se Gjykata Themelore thjesht e ka përmendur këtë duke pasur parasysh të vepruarit në një asi mënyre pa e dhënë më parë bile as paralajmërimin më të vogël. Gjakftohtësia me të cilën ka vepruar i pandehuri si edhe mos dhënia e paralajmërimit, nuk i përbëjnë elementet e nenit 329, paragrafi 5 të KPRK-së. Prandaj Gjykata Themelore përsëri ka qenë në kufijtë e vet për t'i përcaktuar këto të njëjtat si rrethana rënduese. Lidhur me pendimin e të pandehurit, kolegji konsideron se duke pasur parasysh bashkëveprimin gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore është në pozicionin më të përshtatshëm për ta përcaktuar sinqeritetin e pendimit të shfaqur nga i pandehuri. Kolegji nuk gjen asnjë arsye apo bazë për të pasur mëdyshje ose për ta ndryshuar vlerësimin e Gjykatës Themelore se pendimi i shfaqur dukej të ishte i rrejshëm.

Po ashtu kolegji me kujdes i ka shqyrtuar rrethanat lehtësuese të të pandehurit dhe kundërshtimet e ngritura nga mbrojtësi në këtë aspekt. Gjykata Themelore e ka përmendur një rrethanë lehtësuese respektivisht faktin se i pandehuri nuk ka të kaluar kriminale. Gjykata Themelore nuk ka përmendur asnjë rrethanë tjetër lehtësuese. Megjithatë kolegji vë në pah faktin se i pandehuri i ka pranuar veprimet të cilat i ka kryer. Gjithashtu kolegji vë në pah gjendjen familjare dhe financiare të të pandehurit. Siç është theksuar edhe më sipër, kolegji nuk gjen asnjë rrethanë lehtësuese në pendimin e shfaqur nga i pandehuri. Për më tepër, fakti që pala e dëmtuar ka mbijetuar është thjesht çështje fati. Pala e dëmtuara ka mbijetuar pavarësisht veprimeve të ndërmarra nga i pandehuri dhe sigurisht jo për shkak të veprimeve të të pandehurit. Prandaj fakti që pala e dëmtuar pësoi plagë relativisht të lehta nuk mund të jetë absolutisht një rrethanë lehtësuese. Po ashtu, fakti i thjeshtë që pala e dëmtuar nuk mori pjesë në procedurë penale apo që

nuk kërkoi kompensim nuk lë të nënkuptohet dhe nuk mund të konsiderohet si një rrethanë lehtësuese.

Pas marrjes parasysh të të gjitha këtyre rrethanave të përmendura më sipër, kolegji konsideron se edhe pse Gjykata Themelore nuk i përmendi të gjitha rrethanat lehtësuese në aktgjykimin e saj, në të vërtetë nuk ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet me shqiptimin e një dënimi më të butë përveç atij të shqiptuar nga Gjykata Themelore. Në kuadër të kësaj që u tha, kolegji prandaj konsideron se dënimi unik prej 10 (dhjetë) vjet burgim të shqiptuar nga Gjykata Themelore nuk është jo proporcional dhe pasqyron një dënim të përshtatshëm në pikëpamje të rrethanave të lëndës aktuale.

C. Vërejtje përmbyllëse

Për arsyet e shtjelluara më sipër, Gjykata e Apelit e refuzon ankesën dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar.

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim është kryer më 4 janar 2015.

Kryetarja e kolegjit

**Hajnalka Veronika Karpati
Gjyqtare e EULEX-it**

Anëtar i kolegjit

**Abdullah Ahmeti
Gjyqtar kosovar**



Anëtar i kolegjit

**Radostin Petrov
Gjyqtar i EULEX-it**

Procesmbajtësi

Alan Vasak
Zyrtar ligjor i EULEX-it



Gjykata e Apelit
Prishtinë

PAKR 229/15

30 nëntor 2015